



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale
Mbledhja nr. 33
Ndërtesa e Kuvendit, salla N - 303
Prishtinë, më 23 janar 2019, në orën 10:00

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Besa Baftiu, Fatmire Mulhaxha-Kollçaku, Flora Brovina, Fikrim Damka, Drita Millaku, Haxhi Avdyli, Time Kadrijaj, dhe Naser Rugova.

Munguan: Miljana Nikoliq, Bekim Haxhiu dhe Enver Hoti.

Pjesëmarrës tjerë: Brikenë Hoxha IKS, Elvanda Gojani K10, KDI dhe Ekonomia Online.

Mbledhjen e kryesoi, Besa Baftiu, kryetare e Komisionit.

RENDI I DITËS:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 12.12.2018, 19.12.2018 dhe 26.12.2018;**
- 3. Miratimi i raportit të punës së Komisionit për vitin 2018;**
- 4. Shqyrtimi i draft planit të punës së Komisionit për vitin 2019;**
- 5. Të ndryshme.**

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**

Rendi i ditës u miratua pa asnjë ndryshim.

- 2. Miratimi i procesverbaleve të mbledhjeve të mbajtura më 12.12.2018, 19.12.2018 dhe 26.12.2018;**

Procesverbalet e mbledhjeve të mbajtura më 12.12.2018, 19.12.2018 dhe 26.12.2018, u miratuan pa vërejtje.

3. Miratimi i raportit të punës së Komisionit për vitin 2018;

Besa Baftiu, kryetare, pasi i përshëndeti deputetët dhe iu uroi punë të mbarë për këtë vit, theksoi se sa i përket raportit të punës së Komisionit për vitin 2018, i cili është përgatitur nga stafi mbështetës i Komisionit, në raport janë përfshirë pothuajse të gjitha aktivitetet që i kemi bërë si Komision. Ndoshta ka pasur ndonjë aktivitet nga anëtarët e Komisionit që kemi marrë pjesë dhe që nuk është përfshirë në raportin e punës, po arsyeja është që stafi nuk ka qenë i informuar.

Janë mbajtur 25 mbledhje, kemi pasur takime të ndryshme, të gjitha kërkesat që i janë adresuar Komisionit tonë, ne i kemi trajtuar në Komision dhe kemi shkuar konform rregullores së Kuvendit. Gjithashtu, kemi pasur në raportim edhe ministrin e Shëndetësisë dhe ministrin e Punës dhe Mirëqenies Sociale.

Jemi në shqyrtim të Projektligjit për Inspektoratin e Punës dhe së shpejti do të formojmë edhe grupin punues për Projektligjin e KES-it. Jemi duke e monitoruar Ligjin për Produkte dhe Pajisje Medicinale.

Komisioni, pas diskutimit miratoi raportin e punës për vitin 2018, pa vërejtje.

4. Shqyrtimi i draft planit të punës së Komisionit për vitin 2019;

Besa Baftiu, tha se në bazë të rregullores së Kuvendit dhe praktikës së komisioneve parlamentare të Kuvendit të Republikës së Kosovës, e kemi hartuar së bashku planin e punës dhe besoj se e kemi analizuar dhe e kemi shqyrtuar. Nëse kemi diçka për të shtuar rreth kësaj plani ende nuk është përfundimtar, bashkërisht me organizatën Iniciativa Kosovare për Stabilitet – IKS dhe organizatat tjera, do të punojmë që ta plotësojmë me aktivitetet për vitin 2019.

Projektligjet që i kemi pasur në planin e punës në vitin e kaluar nga Ministria e Shëndetësisë, nuk i kemi në këtë plan të punës sepse Projektligjin për Sigurime Shëndetësore, i cili duhet të vinte për plotësim ndryshim nuk është. Projektligji për Shëndetësi është diku në fund të vitit, varësisht a do të vijë apo jo, prandaj nuk e di se si e ka paraparë ministri implementimin e sigurimit Shëndetësor.

Në planin e punës është paraparë që në muajin shkurt, dy ministrat të vijnë në raportim në Komision dhe prej tyre do të mësojmë arsyet, përse nuk është Ligji në plotësim ndryshim për Sigurime Shëndetësore dhe pse ka vonesa në dy ligjet bazike për shëndetësi.

Sot e kemi prezent partnerin që po na mbështet që nga fillimi. Është Brikenë Hoxha nga IKS-ja. Do të realizojmë një punëtori, ku bashkërisht me partnerët do të shqyrtojmë planin e punës. Propozoj që në fillim të javës së ardhshme, të mbahet punëtorja dhe të miratojmë planin e punës për vitin 2019.

Do të ftojme partnerët tanë që na kanë mbështetur në vazhdimësi OBSH-në, IKS-në, KDI-në, FES-in dhe të diskutojmë bashkërisht planin e punës dhe të shohim se si mund t'na mbështesin për vitin 2019.

Kemi disa Projektligje të rëndësishme, dëgjime publike gjithashtu edhe vizita studimore dhe për këtë arsye, është e rëndësishme që të jemi të gjithë aty dhe të shohim se çfarë mund të planifikojmë.

Flora Brovina, tha se sa i përket planit të punës së Komisionit për vitin 2019, kemi vërejtje sepse fjalët janë të mëdha, ndërsa programi i ministrive është i varfër, por do të diskutojmë në takimin e radhës.

5. Të ndryshme.

Kryetarja, - tha se i kemi dy kërkesa; një e kemi nga Këshilli për Financim të viteve 90-99 me personat që faktikisht janë marrë me pagesat e mësuesve dhe ata me sa e dimë nuk janë futur në Ligjin i viteve '90, që ka kaluar në Kuvend.

E kemi edhe një kërkesë nga Sindikata e Pavarur e Administratës Publike për Ligjin për Skemat Pensionale të Financuara nga Shteti. Ne kemi kërkuar nga MPMS-ja, që të plotësohet dhe ndryshohet neni 8. Ministri ka thënë se do të bëhet reforma e sistemit pensional dhe në atë mënyrë do të përfshihen ato kërkesa. Në Komision kemi pasur Shoqata të ndryshme të pensionistëve dhe i kemi marrë vërejtjet e tyre dhe e dimë që ky Ligj është diskriminues ndaj tyre. Ne program legjislativ gjatë shqyrtimit, do t'i kemi parasysh shqetësimet që kanë ardhur.

Fikrim Damka, tha se ne si komision për buxhet kemi shqyrtuar amendamentet e komisionit tonë për Shëndetësi, ku kemi kërkuar 3 milion euro për Klinikën e Onkologjisë, sa i përket zgjerimit të hapësirës së këtij reparti dhe blerjen aparaturave. E diskutuam me ministrin dhe nga ai është thënë se mund të sigurojmë vetëm 1.5 milion dhe në bashkëbisedim me drejtorin e Onkologjisë, u vendos që me këto mjete të blihet aparatura në vlerë 1.5 milion.

Në amendament duhet të sqarohet, që ne kemi pasur kërkesë për zgjerim të hapësirës dhe për blerjen e aparaturës.

Kryetarja, tha se është e vërtetë që i kemi kërkuar 3 milion euro, duke pasur parasysh edhe për zgjerim të hapësirës, por duke parë që aparatura është më urgjente, unë po mendoj që duhet përkrahur, sepse shumë më mirë është të dalë amendamenti me përkrahje të Komisionit, së paku për aparaturë, se sa të del amendamenti edhe për zgjerim të hapësirës, por pa përkrahje të Kuvendit.

Fatmire Kollqaku, tha se është mirë që ta cekim se çfarë kemi kërkuar dhe çfarë është arritur. Jam e mendimit që gjatë këtij viti, ne të vazhdojmë ta shtyjmë kërkesën tonë deri në fund, kur buxheti të rishikohet. Meqenëse ka qenë iniciativa e Komisionit, mendoj që më mirë është të shkoj si amendament i ndryshuar nga ne, por do të ishte mirë, që në seancë të sqarohet se si ka qenë kërkesa fillestare, por meqenëse mund të realizohet vetëm në këtë formë, do të ketë përkrahje nga Komisioni.

Komisioni diskutoi në lidhje me dy amendamentet e propozuara për Projektligjin për buxhetin për vitin 2019. Pas diskutimit vendosi që të tërheq amendamentin për zgjerimin e hapësirave të Klinikës së Onkologjisë për arsye se nuk e mori përkrahjen e Komisionit për Buxhet, ndërsa amendamenti për blerjen e pajisjeve për Klinikën e Onkologjisë, do të procedohet me përkrahjen e Komisionit Funkcional për Buxhet dhe Financa.

Haxhi Avdyli, ngriti shqetësimin rreth j televizionit, siç tha ky kur e lëshoj, me fëmijët e mijë shoh spote të ndryshme, ku promovohen lëndët narkotike. Çfarë mund të ndërmarrim ne si Komision për parandalimin e këtyre promovimeve të vazhdueshme që po iu bëhet substancave narkotike.

Flora Brovina, tha se unë mendoj se duhet të organizojmë një tryezë me media dhe ne t'i shfaqim ankesat tona sepse ata nuk po punojnë mjaftueshëm në luftën kundër narkotikëve. Aty mandej, në bazë të diskutimeve do të vijmë tek një konkluzion dhe në qoftë se duhet do të bëjmë një iniciativë ligjore, do ta bëjmë. Unë kam vërejtje edhe tek përdorimi i duhanit sepse mediat nuk po e zbatojnë Ligjin për Duhanin.

Komisioni, e përkrahu shqetësimin e z. Haxhiu dhe vendosi se do të shqyrtojë mundësinë e adresimit të kësaj problematike në të ardhmen dhe do të shqyrtohet mundësia se si do të veprohet.

Mbledhja përfundoi në orën 10:36.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,

Besa BAFTIU